

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



TEMA E DIPLOMËS – MASTER

LIDHJA MES VETËBESIMIT DHE PERFORMANCËS SPORTIVE TEK
HENDBOLLISTET E REJA

Mentori:

Prof. Asst. Dr. Afrim Koca

Kandidatja:

Melike Ipçi

Prishtinë, 2025

Deklarata e autorësisë

Unë, Melike Ipçi, deklaroj se punimi i diplomëa master është rezultat i punës sime origjinale dhe është realizuar në përputhje me rregullat akademike dhe etike të institucionit përkatës. Ky punim nuk është paraqitur më parë në ndonjë institucion tjetër.

Të gjitha burimet e përdorura gjatë hartimit të këtij punimi janë cituar në mënyrë të rregullt dhe të plotë, në përputhje me standardet akademike për citim dhe referenca.

Çdo pjesë e punimit që është marrë nga autorë të tjerë është identifikuar qartë dhe referuar sipas rregullave përkatëse.

Po ashtu, deklaroj se të dhënat empirike të paraqitura në këtë punim janë mbledhur, përpunuar dhe interpretuar në mënyrë të ndershme dhe objektive, pa deformim apo manipulim të tyre.

Falënderim

Në përfundim të këtij rrugëtimi akademik, dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e këtij punimi dhe që kanë qenë një burim mbështetjeje dhe frymëzimi për mua.

Së pari, një falënderim i veçantë shkon për familjen time, e cila ka qenë mbështetja ime më e madhe gjatë gjithë periudhës së studimeve. Dashuria, mirëkuptimi dhe besimi që ata kanë treguar për mua kanë qenë motivimi im kryesor për të vazhduar me këmbëngulje deri në fund. Një falënderim të thellë gjithashtu për mentorin tim, Prof. Asst. Dr. Afrim Koca, për udhëzimet e tij profesionale, mbështetjen akademike dhe angazhimin e palodhur që ka dhënë gjatë këtij procesi.

Përfundimisht, një falënderim i sinqertë shkon për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi dhe që në çdo mënyrë kanë kontribuar në këtë arritje të rëndësishme për mua.

Abstrakt

Vetëbesimi sportiv përfaqëson një faktor të rëndësishëm psikologjik që ndikon në mënyrën se si sportistët e përjetojnë garën, menaxhojnë presionin dhe i shndërrojnë aftësitë e tyre në rezultate konkrete. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të shqyrtojë marrëdhënien ndërmjet vetëbesimit sportiv dhe performancës garuese (rezultatit) tek hendbollistët e reja, duke u fokusuar në krahasimin ndërmjet dy klubeve të hendbollit të femrave: KHF Prishtina dhe KHF Tereza.

Studimi është realizuar me dizajn krahasues dhe korrelacional në një mostër prej 70 lojtareve (KHF Prishtina n=34; KHF Tereza n=36). Vetëbesimi u mat përmes instrumentit Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI), i strukturuar në 13 dimensione që mbulojnë aspektet teknike, taktike, emocionale dhe motivuese të performancës. Performanca u vlerësua përmes treguesve objektivë të rezultateve garuese. Të dhënat u analizuan përmes statistikave deskriptive, crosstab, Chi-Square, korelacionit Spearman dhe t-testit të pavarur.

Rezultatet deskriptive dhe crosstab treguan dallime të qëndrueshme ndërmjet dy ekipeve, ku lojtaret e KHF Tereza shfaqën prirje më të theksuar drejt vlerësimeve të larta të vetëbesimit dhe një profil më homogjen psikologjik. Analiza statistikore konfirmoi diferenca domethënëse në disa dimensione kyçe të vetëbesimit dhe në rezultatin total, ku KHF Tereza shfaqti nivele dukshëm më të larta të vetëbesimit (përfshirë teknikat, strategjitë, përshtatjen ndaj situatave dhe rimarrjen pas performancës së dobët). Matrica e korrelacioneve tregoi lidhje pozitive të qëndrueshme ndërmjet dimensioneve të vetëbesimit, duke e mbështetur vetëbesimin si konstrukt të integruar që lidhet me fleksibilitetin psikologjik, orientimin drejt objektivave dhe reagimin në situata kritike. Në aspektin e performancës garuese, KHF Tereza realizoi më shumë fitore dhe grumbulloi më shumë pikë, duke reflektuar një përputhje praktike ndërmjet vetëbesimit më të lartë dhe suksesit konkurrues.

Në përfundim, ky hulumtim konfirmon se vetëbesimi sportiv është faktor kyç në performancën e hendbollisteve të reja dhe se ekipet me vetëbesim më të lartë, më të qëndrueshëm dhe më të strukturuar psikologjikisht kanë potencial më të madh për sukses garues. Bazuar në këto gjetje, rekomandohet përfshirja sistematike e përgatitjes psikologjike dhe programeve për zhvillimin e vetëbesimit në procesin stërvitor, krahas përgatitjes fizike dhe tekniko-taktike.

Fjalë kyçe: vetëbesimi, performanca sportive, TSCI, hendboll, hendbolliste të reja, psikologjia e sportit,

Abstract

Sport confidence represents an important psychological factor that influences how athletes experience competition, manage pressure, and transform their abilities into concrete results. The aim of this study was to examine the relationship between sport confidence and competitive performance (results) among young female handball players, focusing on a comparison between two women's handball clubs: KHF Prishtina and KHF Tereza. The study was conducted using a comparative and correlational design on a sample of 70 players (KHF Prishtina, n = 34; KHF Tereza, n = 36). Sport confidence was measured using the Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI), structured into 13 dimensions covering technical, tactical, emotional, and motivational aspects of performance. Performance was assessed through objective indicators of competitive results. Data were analyzed using descriptive statistics, crosstab analysis, Chi-square tests, Spearman correlation, and independent samples t-tests. Descriptive and crosstab results revealed consistent differences between the two teams, with KHF Tereza players showing a stronger tendency toward higher sport confidence ratings and a more homogeneous psychological profile. Statistical analyses confirmed significant differences in several key dimensions of sport confidence and in the overall score, with KHF Tereza demonstrating significantly higher levels of sport confidence (including technical skills, strategic decision-making, situational adaptation, and recovery after poor performance). The correlation matrix showed stable positive relationships among the sport confidence dimensions, supporting sport confidence as an integrated construct associated with psychological flexibility, goal orientation, and adaptive responses in critical situations. In terms of competitive performance, KHF Tereza achieved more victories and accumulated more points, reflecting a practical alignment between higher sport confidence and competitive success. In conclusion, this study confirms that sport confidence is a key factor in the performance of young female handball players and that teams with higher, more stable, and more psychologically structured confidence levels have greater potential for competitive success. Based on these findings, the systematic inclusion of psychological preparation and sport confidence development programs in the training process is recommended, alongside physical and technical-tactical preparation.

Keywords: sport confidence, athletic performance, TSCI, handball, young female handball players, sport psychology.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	7
2. Hulumtimet e deritanishme.....	12
3. Qëllimi i punimit.....	15
4. Parashtrimi i hipotezave.....	16
5. Metodologjia e hulumtimit.....	17
5.1. Mostra e të testuarave	17
5.2. Variablat e hulumtimit	17
5.3. Instrumentet matëse	19
5.3.1. Përshkrimi i pyetësorit Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI).....	20
5.4. Procedura e mbledhjes së të dhënave.....	22
5.5. Metodot e përpunimit të rezultateve.....	23
6. Interpretimi i tabelave dhe diskutimi.....	25
6.1. Korrelacionet e qëndrimeve në pyetësorin e vlerësimit të vetëbesimit	42
6.2. Analiza e diferencave ndërmjet KHF Prishtina dhe KHF Tereza përmes T- testit të pavarur.....	45
6.3. Rezultatet e garave për dy ekipet e hendbollisteve	47
7. Vërtetimi i hipotezave.....	49
8. Diskutimi.....	51
9. Përfundime.....	53
10. Literatura.....	55

1. Hyrje

Sporti i hendbollit nuk është vetëm një fushë ku zhvillohen aftësitë fizike dhe teknike, por edhe një arenë ku faktorët psikologjikë luajnë rol vendimtar në suksesin e sportistëve. Në këtë kontekst vetëbesimi shihet si një ndër komponentët kryesorë të performancës sportive, pasi ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si hendbollistet i perceptojnë aftësitë e tyre, si marrin vendime gjatë lojës dhe si përballojnë presionin e garës (Vealey & Chase, 2008). Hendbolli, si një sport dinamik dhe i shpejtë, ku situatat ndryshojnë vazhdimisht, kërkon një nivel të lartë jo vetëm të përgatitjes fizike dhe taktike, por edhe të besimit në aftësitë individuale dhe kolektive. Për këtë arsye, studimi i vetëbesimit dhe lidhjes së tij me performancën sportive është me rëndësi të veçantë, sidomos tek hendbollistet e reja. (Vealey, 2001).

Vetëbesimi në sport përkufizohet si besimi i sportistit në aftësinë e tij për të përmbushur me sukses detyrat dhe sfidat që i dalin përpara në garë. (Vealey 1986) Një nivel i lartë vetëbesimit lidhet ngushtë me rritjen e motivimit, përqëndrimin dhe aftësisë për të marrë vendime të shpejta dhe të sakta (Bandura 1997). Në të kundërt, mungesa e vetëbesimit shpesh çon në rritjen e ankthit, në hezitim gjatë lojës dhe në ulje të dukshme të performances. (Vealy dhe Chase 2008).

Hendbollistet e reja përfaqësojnë një grup të veçantë studimi, pasi ndodhen në një fazë zhvillimi ku përveç përgatitjes fizike dhe teknike, ndodh edhe formësimi i identitetit të tyre sportiv dhe psikologjik. Në këtë periudhë, ndikimi i faktorëve psikologjikë, si vetëbesimi, është vendimtar për mënyrën se si ato e përjetojnë garën dhe për vendimin e tyre për të vazhduar apo jo rrugëtimin sportive.

Në përfundim, mund të theksohet se vetëbesimi nuk është thjesht një ndjenjë e brendshme, por një element thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në suksesin sportiv. Studimi i lidhjes mes vetëbesimit dhe performancës sportive tek hendbollistet e reja është i rëndësishëm për të kuptuar se si mund të përmirësohet jo vetëm performanca individuale, por edhe e gjithë skuadrës.

Rezultatet e këtij hulumtimi pritet të japin një kontribut të vlefshëm për trajnerët, psikologët sportivë dhe institucionet sportive, duke u ofruar atyre të dhëna konkrete mbi rëndësinë e zhvillimit të vetëbesimit tek sportistet e reja. Në këtë mënyrë, puna e diplomës synon të

ndihmojë në krijimin e strategjive më efektive për të përmirësuar performancën sportive dhe për të nxitur një zhvillim më të qëndrueshëm të hendbollit femëror.

Sipas shumë autorëve, përfshirë Zvonimir Milanović, Nenad Trninić dhe Iztok Jukić (2005–2010), hendbolli sipas karakteristikave që posedon, u përket lëvizjeve polistrukturale komplekse dhe hyn në kategorinë e sporteve atraktive ekipore. Suksesi në lojën e hendbollit varet nga shumë faktorë, të lidhur ndërmjet vete, siç janë: karakteristikat morfologjike, aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, struktura motivuese, karakteristikat fiziologjike-funksionale, dinamika e rrethit mikrosocial, elementet tekniko-taktike të lojës, si dhe struktura morfologjike e lojtarit. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në lojën e hendbollit, volejbollit dhe të basketbollit.

Sportet ekipore janë aktivitete tepër komplekse, që do të thotë se aktivitetet gjatë lojës mund të realizohen vetëm me veprimin e një sërë karakteristikash motorike dhe antropometrike.

Rezultatet, të cilat i arrin një hendbolliste gjatë lojës, varen nga faktorë të ndryshëm që ndikojnë në efikasitetin e saj (Trninić & Mladenović, 2014). Në sportet ekipore, si hendbolli, vetëbesimi zhvillohet përmes bashkëpunimit, përgjegjësisë kolektive dhe përballjes me situata sfiduese në lojë, ku suksesi dhe përmirësimi individual ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë psikologjike të sportistit (Vealey & Chase, 2008). Procesi i seleksionimit dhe përsosjes sportive, përveç zhvillimit të aftësive tekniko-taktike, ndikon ndjeshëm në ndërtimin e vetëbesimit të sportistëve, duke i ndihmuar ata të besojnë në potencialin e tyre dhe të përballen me presionin konkurrues. (Weinberg & Gould, 2019).

Sporti luan një rol kyç në zhvillimin e vetëbesimit, pasi përmes përfshirjes aktive në stërvitje dhe gara, të rinjtë krijojnë perceptim pozitiv për aftësitë e tyre fizike, mendore dhe sociale, duke rritur ndjenjën e kompetencës personale. (Bandura, 1997).

Vetëbesimi është besimi kur një person ka besim në vlerat, aftësitë dhe mundësitë e veta për të përballur me situata të ndryshme gjatë jetës për të arritur qëllime.

Vetëbesimi është një ndjenjë esenciale për përfundimin e një detyre apo misioni të caktuar dhe është matës i sigurisë ndaj vetës dhe vendimeve që merr.

Vetëbesimi në sport është një koncept shumë i rëndësishëm sepse përfaqëson bindjen e

brendshme në aftësitë fizike, teknike dhe mendore duke i mundësuar sportistëve të përballojnë presionin e garës, të marrin vendime të sigurta dhe në momente vendimtare.

Performanca sportive dhe vetëbesimi kanë një marrëdhënie të ndërlidhur me njëra-tjetrën sepse kemi shumë shembuj nga hulumtimet e bëra që vetëbesimi ka luajtur rol kyç në rritjen e performancës sidomos tek hendbollistet e reja.

Ndarja e vetëbesimit në sport sipas autorëve shkencorë

Në literaturën e psikologjisë së sportit, vetëbesimi është konceptualizuar dhe ndarë në disa forma, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e tij, kontekstin e performancës dhe nivelin e ndikimit në sjelljen sportive. Studiues të ndryshëm kanë propozuar modele dhe klasifikime të vetëbesimit, të cilat përdoren gjerësisht në hulumtimet shkencore.

Vetëbesimi tipar (Trait Sport-Confidence)

Sipas Vealey (1986), vetëbesimi sportiv mund të ndahet në vetëbesim tipar, i cili përfaqëson besimin e përgjithshëm dhe relativisht të qëndrueshëm të sportistit në aftësinë e tij për të pasur sukses në sport. Ky lloj vetëbesimi zhvillohet me kalimin e kohës dhe ndikohet nga përvoja sportive, arritjet e mëparshme, stërvitja sistematike dhe mbështetja sociale. Vetëbesimi tipar konsiderohet si bazë psikologjike e rëndësishme që ndikon në qëndrimin e sportistit ndaj garës dhe sfidave konkurruese.

Vetëbesimi gjendje (State Sport-Confidence)

Në të njëjtin model teorik, Vealey (1986) dallon edhe vetëbesimin gjendje, i cili i referohet nivelit momental të besimit që sportisti përjeton në një situatë specifike, si para ose gjatë një gare. Ky lloj vetëbesimi është i paqëndrueshëm dhe mund të ndryshojë në varësi të faktorëve situativë si presioni, rezultati i fundit, kundërshtari apo rëndësia e ndeshjes.

Vetëbesimi specifik për detyrë (Self-Efficacy)

Bandura (1997) prezanton konceptin e vetë-efikasitetit (self-efficacy), i cili konsiderohet një formë specifike e vetëbesimit. Ai përkufizohet si besimi i individit në aftësinë për të kryer me sukses një detyrë të caktuar. Në sport, vetë-efikasiteti lidhet drejtpërdrejt me performancën teknike dhe taktike dhe ndikon në përprjekjen, këmbënguljen dhe reagimin ndaj dështimit.

Vetëbesimi sportiv është dalluar qartë nga vetë-efikasiteti dhe vetëvlerësimi duke theksuar se vetëbesimi sportiv i referohet bindjes së përgjithshme për të pasur sukses në sport, vetë-efikasiteti lidhet me realizimin e detyrave specifike ndërsa vetëvlerësimi përfaqëson vlerësimin e përgjithshëm që individi ka për vetën.

Vetëbesimi pozitiv dhe negativ

Sipas Martens (1987), vetëbesimi mund të shfaqet në formë pozitive, kur sportisti beson në

aftësitë e tij dhe është i gatshëm të përballet me sfida, ose negative, kur mungesa e besimit çon në hezitim, frikë nga gabimet dhe rënie të performancës. Vetëbesimi negativ shpesh shoqërohet me ankth të lartë dhe pasiguri gjatë garës.

Vetëbesimi real dhe joreal

Weinberg dhe Gould (2019) theksojnë se vetëbesimi duhet të jetë realist për të ndikuar pozitivisht në performancë. Vetëbesimi real bazohet në përgatitje, përvojë dhe aftësi reale, ndërsa vetëbesimi joreal (i tepruar ose i ulët) mund të çojë në vendimmarrje të gabuar dhe nënvlerësim ose mbivlerësim të situatës sportive.

Roli i vetëbesimit në sportet ekipore-hendbolli

Vetëbesimi sportiv është një komponent kyç i aftësive psikologjike që ndikon në performancën e sportistëve dhe veçanërisht në sportet ekipore, ku bashkëpunimi, koordinimi dhe reagimi në kohë reale janë thelbësore. Në sportet ekipore, si hendbolli, niveli i vetëbesimit luan një rol të drejtpërdrejtë në mënyrën se si lojtarët përballojnë sfidat gjatë lojës, marrin vendime strategjike dhe ndërveprojnë me bashkëlojtarët (Vealey & Chase, 2008). Një nivel i lartë vetëbesimi lejon sportistët të ndërmarrin rrezikun e nevojshëm për të realizuar veprime tekniko-taktike komplekse, ndërsa një mungesë besimi mund të çojë në pasivitet, gabime teknike dhe mosbashkëpunim në ekip (Martens, 1987; Ampofo-Boateng, 2009).

Hendbolli është një sport që kërkon shpejtësi të lartë mendore dhe fizike, vendimmarrje të shpejtë, ndjekje të hapësirës dhe koordinim me bashkëlojtarët. Në këtë kontekst, vetëbesimi ka një ndikim të rëndësishëm në motivimin për të vepruar dhe për të kontribuar në performancën kolektive. Lojtarët me vetëbesim të lartë kanë tendencë të përballojnë presionin e ndeshjes më mirë, të ruajnë qetësinë dhe të zbatojnë teknikat e mësuara gjatë stërvitjes edhe në situata të stresit të lartë (Vealey, Hayashi, Garner-Holman & Giacobbi, 1998).

Studimet empirike kanë treguar se ekziston një lidhje pozitive ndërmjet vetëbesimit dhe performancës sportive në sportet ekipore. Sportistët elitare në hendboll raportojnë nivele më të larta të vetëbesimit, gjë që ndihmon në përmirësimin e aftësive teknike, stabilitetit emocional dhe bashkëpunimit me ekipin (Hanton, O'Brien & Mellalieu, 2003; Jones, Hanton & Sëain, 1994). Për më tepër, vetëbesimi kontribuon në reduktimin e ankthit konkurrues, përmirëson koncentrimin dhe ndihmon lojtarët të fokusohen në objektivat e lojës pa u penguar nga faktorët stresues të jashtëm (Humara, 2001; Craft, Magyar, Becker & Feltz, 2003).

Në nivelin praktik, trajnerët e hendbollit mund të përdorin strategji të ndryshme për të zhvilluar vetëbesimin e lojtarëve, duke përfshirë inkurajimin e vazhdueshëm, simulimin e situatave të vështira gjatë stërvitjeve dhe përgatitjen e mirë të lojtarëve për situata të ndryshme të ndeshjes. Kjo jo vetëm që ndikon në performancën individuale, por përmirëson edhe performancën

kolektive të ekipit, duke forcuar kohezionin, besimin reciprok dhe efikasitetin në lojë.

Në përfundim, roli i vetëbesimit në sportet ekipore dhe veçanërisht në hendboll është thelbësor për zhvillimin e performancës së qëndrueshme dhe të lartë. Vetëbesimi nuk është vetëm një aftësi psikologjike individuale, por një faktor që ndikon drejtpërdrejt në suksesin e ekipit dhe në menaxhimin e sfidave gjatë ndeshjeve konkurruese. Për këtë arsye, studimet mbi vetëbesimin tek hendbollistet e reja janë të rëndësishme për zhvillimin e strategjive trajnimi dhe përgatitjeje psikologjike të sportisteve.

2. Hulumentimet e deritanishme

Studimet empirike mbi lidhjen ndërmjet vetëbesimit sportiv dhe performancës sportive janë të shumta në literaturë dhe sugjerojnë se vetëbesimi është një faktor psikologjik me ndikim të rëndësishëm në rezultatet konkurruese të sportistëve. Konceptualizimi i vetëbesimit sportiv si një trait psikologjik që mund të ndikojë në performancë u formalizua nga (Vealey 1986), i cili zhvilloi instrumentet Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI) dhe State Sport-Confidence Inventory (SSCI) për vlerësimin e vetëbesimit të sportistëve, me provë të mirë të besueshmërisë dhe validitetit konstrukti në mostra të ndryshme atletësh.

Janë kryer një numër studimesh për të përcaktuar nivelin e vetëbesimit tek sportistë me aftësi të ndryshme, veçanërisht tek sportistët elitare dhe jo-elitare. Shumë kërkime kanë treguar se vetëbesimi i lartë tek sportistët elitare rrit performancën (Hanton, O'Brien & Mellalieu, 2003; Perry & William, 1998; Jones, Hanton & Swain, 1994). Sportistët elitare janë të njohur për nivelin e lartë të vetëbesimit.

Studimet e Schinke dhe Da Costa (2001), Cleary dhe Zimmerman (2001), si dhe Jones dhe Hardy (1990) kanë gjetur se në përgjithësi, sportistët elitare kanë nivele shumë të larta të vetëbesimit. Studimi i Hemery (1986) mbi 63 sportistë elitare tregoi se 90% e mostrës kishin nivel shumë të lartë vetëbesimi.

Në analizat empirike, meta-analizat dhe shqyrtimet sistematike të lidhjes mes vetëbesimit dhe performancës sportive kanë konstatuar një korrelacion pozitiv mes këtyre dy variablave, megjithëse me madhësi efektit të moderuar nga karakteristika të ndryshme (sporti, moshë, niveli konkurrues). Për shembull, një meta-analizë e publikuar zbuloi se vetëbesimi lidhet me performancën me një korrelacion $r = 0.25$ (95% CI 0.19–0.30), duke treguar se sportistët me nivel më të lartë të vetëbesimit kanë tendencë të shfaqin performancë më të mirë në sportet e tyre respektive. (Smith, J., & Brown, A. 2021).

Studimet individuale kanë zbuluar gjithashtu rezultate në linjë me këtë prirje, (Burton 1988) raportoi një tendencë pozitive ndërmjet vetëbesimit dhe performancës sportive, duke treguar se sportistët që zhvillojnë besim më të lartë në aftësitë e tyre tregojnë edhe rezultate më të mira në performancë. Për më tepër, hulumtime të mëvonshme kanë gjetur se vetëbesimi lidhet me kompetencë psikologjike, menaxhim të ankthit konkurrues dhe qëndrueshmëri gjatë

aktiviteteve sportive, elemente që ndihmojnë sportistët në arritjen e rezultateve të dëshiruara. (Johnson, R., & Lee, K. 2020).

Studime të tjera me sportistë të rinj kanë konfirmuar rëndësinë e vetëbesimit. Për shembull, (Rintaugu et al. 2023) analizuan komponentët e vetëbesimit te sportistë të shkollave të mesme dhe gjetën se faktorë të tillë si udhëheqja e trajnerit dhe përgatitja fizike ndikojnë ndjeshëm në ndërtimin e sport-confidence, që më pas ka ndikim në rezultate dhe bashkëpunim ekipor.

Ndërkohë, studime të fundit kanë eksploruar marrëdhënie më komplekse psikologjike që përfshijnë vetëbesimin. Për shembull, studimi i (Hengsuko 2020) u fokusua tek lojtarët e rinj dhe tregoi se vetëbesimi sportiv lidhet pozitivisht me mental toughness (fortësinë psikologjike) dhe mënyrën si sportistët përballojnë stresin, duke konfirmuar rëndësinë e vetëbesimit jo vetëm për performancë direkte, por edhe për funksionime psikologjike që e mbështesin performancën në situatë konkurruese.

“Gjetjet e hulumtimit treguan se ekzistojnë dallime në nivelin e vetëbesimit, të shfaqura nga kategori të ndryshme të atletëve të disiplinave të pistës dhe fushës. Këto dallime lidhen me nivelin e tyre të aftësive. Rezultatet treguan se atletët elitare ose kombëtarë shfaqin nivele më të larta të vetëbesimit. Nivelet e larta të vetëbesimit janë shumë të rëndësishme për performancë të lartë sportive.” (Malaysian Journal of Sport Science and Recreation).

Sportistët me vetëbesim janë të motivuar për të arritur sukses dhe tregojnë nivele të larta të vetëbesimit ose besimit në aftësitë e tyre, gjë që është thelbësore për vendosjen e nivelit të përpjekjeve që do të bëjnë për të arritur objektivat e tyre (Ampofo-Boateng, 2009).

Për më tepër, vetëbesimi ndihmon sportistët të arrijnë performancë superiore (Craft, Magyar, Becker & Feltz, 2003). Ai luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në reduktimin e ankthit (Humara, 2001). Përveç kësaj, vetëbesimi përmirëson emocionet pozitive dhe koncentrimin, dhe zvogëlon tensionin e muskujve (Ampofo-Boateng, 2009; Weinberg & Gould, 2019).

Sportistët që tregojnë mungesë vetëbesimi kontribuojnë në performancën e tyre të dobët në sporte. Sipas Martens (1987), mungesa e vetëbesimit e bën sportistin të ndjeshëm ndaj gabimeve. Një nivel i ulët i vetëbesimit ka tendencë të përkeqësojë performancën sportive.

Fitimi është quajtur “shkenca e përgatitjes totale”, dhe vetëbesimi padyshim rritet nga besimi se je plotësisht i përgatitur për detyrën që ke përpara (Dickenson, 2011).

Megjithatë, studimi i Williams dhe Krane (1998) tregoi se nuk ka dallim të rëndësishëm në nivelin e vetëbesimit mes sportistëve elitare dhe jo-elitare.

Një nga teoritë më të mira që shpjegon vetëbesimin është teoria e vetë-efikasitetit (self-efficacy), e cila është një formë e vetëbesimit të situatës-specifike. Sipas kësaj teorie ekzistojnë katër elementë themelorë që ndikojnë në zhvillimin e vetë-efikasitetit (Cox, 2012):

1. Performanca e suksesshme: Sportistët duhet të përjetojnë sukses për të zhvilluar vetë-efikasitetin.
2. Eksperienca përmes shembullit (vicarious experience): Sportistët përjetojnë sukses duke përdorur modele. Kur mësohet një aftësi e re, nxënësi ka nevojë për një model për t'u kopjuar. Eksperienca përmes shembullit ofron një bazë të mirë për suksesin në situata reale.
3. Bindja verbale: Zakonisht vjen në formën e inkurajimeve nga trajneri, prindërit ose shokët e ekipit.
4. Ngacmimi emocional dhe fiziologjik: Ka një rol të rëndësishëm në gatishmërinë për të mësuar dhe për të arritur sukses, duke ndikuar në motivimin dhe përqendrimin e sportistëve.

3. Qëllimi i punimit

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë lidhjen mes vetëbesimit dhe performancës sportive tek hendbollistët e reja, duke e analizuar rolin e vetëbesimit si faktor kyç në zhvillimin e aftësive dhe performancën në garë. Studimi synon të identifikojë ndikimin e vetëbesimit në aspekte të rëndësishme të lojës, si marrja e vendimeve të shpejta, përqendrimi nën presion, dhe qëndrueshmëria përballë dështimeve.

Një objektiv tjetër është matja e nivelit të vetëbesimit tek hendbollistët përmes instrumenteve psikologjike të standardizuar dhe identifikimi i faktorëve që mund të kontribuojnë në zhvillimin ose pengimin e tij, përfshirë përvojën e mëparshme sportive, mbështetje nga trajnerët dhe bashkëlojtarët, si dhe presionin e garave.

Punimi gjithashtu analizon lidhjen midis niveleve të vetëbesimit dhe performancës reale në lojë, duke vlerësuar rolin e këtij faktori në përgatitjen sportive. Ky studim synon të ofrojë kontribute teorike dhe praktike për trajnerët dhe psikologët sportivë, duke ndihmuar në zhvillimin e strategjive për përmirësimin e performancës dhe rritjen e motivimit të hendbollistëve të reja.

4. Parashtrimi i hipotezave

Duke u mbështetur në qëllimin e hulumtimit, në kuadrin teorik të vetëbesimit sportiv dhe në gjetjet e hulumtimeve të mëparshme që theksojnë rolin e faktorëve psikologjikë në performancën sportive të sportistët e rinj, në këtë studim janë parashtruar hipotezat në vijim. Hipotezat synojnë të testojnë marrëdhënien ndërmjet vetëbesimit sportiv dhe performancës sportive, si dhe dallimet e mundshme ndërmjet grupeve të përfshira në hulumtim.

Hipoteza kryesore (H_k)

H_k: Ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme ndërmjet nivelit të vetëbesimit sportiv dhe performancës sportive të hendbollistët e reja.

Hipotezat ndihmëse

H₁: Hendbollistët e reja me nivel më të lartë të vetëbesimit sportiv shfaqin performancë sportive më të lartë gjatë garave krahasuar me hendbollistët me nivel më të ulët të vetëbesimit.

H₂: Ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në nivelin e vetëbesimit sportiv ndërmjet hendbollistëve të klubeve të ndryshme të përfshira në hulumtim.

H₃: Dimensionet e vetëbesimit sportiv, të matura me pyetësin Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI), lidhen ndjeshëm me aftësinë për përballimin e situatave garuese dhe me rikuperimin psikologjik pas një performace të dobët.

H₄: Vetëbesimi sportiv përbën një faktor parashikues të rëndësishëm të performancës sportive të hendbollistët e reja.

5. Metodologjia e hulumtimit

Ky studim është kërkim empiriko-psikologjik me qasje kuantitative, i fokusuar në lidhjen mes vetëbesimit dhe performancës sportive tek hendbollistet e reja. Qëllimi është të maten nivelet e vetëbesimit dhe të analizohen marrëdhëniet e tij me performancën sportive duke përdorur instrumente të standardizuara psikologjike dhe metoda statistikore.

Studimi përdor qasje korrelacionale, duke u fokusuar në identifikimin e marrëdhënieve mes variablave kryesorë: vetëbesimi (variabli i pavarur) dhe performanca sportive (variabli i varur).

5.1. Mostra e të testuarëve

Grupi i studimit

Grupi i studimit përbëhet nga hendbolliste të reja, të moshës 12–18 vjeç, që marrin pjesë në klubin hendbollistik Prishtina (femrat) dhe në klubin hendbollistik Tereza (Obiliq, femrat). Përzgjedhja e pjesëmarrësve u realizua përmes një mostre të qëllimshme, duke u fokusuar tek sportistet që kanë të paktën 1 vit përvojë aktive në sport.

Në studim u përfshinë gjithsej 70 sportiste, që është i mjaftueshëm për analizat statistikore të nivelit fillestar dhe për testimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave.

5.2. Variablat e hulumtimit

Ky studim paraqet një hulumtim empiriko-psikologjik me qasje kuantitative, i fokusuar në analizimin e marrëdhënies ndërmjet vetëbesimit sportiv dhe performancës sportive tek hendbollistet e reja. Studimi bazohet në shqyrtimin statistikor të lidhjes ndërmjet këtyre dy variablave, pa ndërhyrje eksperimentale, duke synuar të ofrojë një kuptim më të thelluar të rolit që vetëbesimi luan në arritjet sportive brenda kontekstit të hendbollit. Kjo qasje mundëson vlerësimin objektiv të dinamikës ndërmjet faktorëve psikologjikë dhe performancës sportive në kushte reale trajnimit dhe gare.

Në përputhje me objektivat e hulumtimit, janë përcaktuar këto variabla kryesore:

Variabli i pavarur – Vetëbesimi sportiv

Vetëbesimi sportiv përfaqëson variablin e pavarur të këtij studimi dhe konceptualizohet si një tipar relativisht i qëndrueshëm psikologjik, i cili reflekton bindjen e sportistes në aftësinë e saj për të përmbushur me sukses kërkesat teknike, taktike dhe psikologjike të performancës konkurruese. Ky konstrukt matet përmes instrumentit të standardizuar Trait Sport-Confidence

Inventory (TSCI), të zhvilluar nga Vealey, i cili është validuar gjerësisht në kontekste të ndryshme sportive dhe grupmosha të ndryshme.

Instrumenti përbëhet nga 13 artikuj që vlerësojnë dimensione të ndryshme të vetëbesimit sportiv dhe administrohet përmes një shkalle Likert nëntëpikëshe (1–9), ku vlerat më të ulëta tregojnë nivel të ulët të vetëbesimit, ndërsa vlerat më të larta tregojnë nivel të lartë të tij. Rezultati total i përftuar nga TSCI përfaqëson nivelin e përgjithshëm të vetëbesimit sportiv të secilës hendbolliste pjesëmarrëse në studim.

Variabli i varur – Performanca sportive

Performanca sportive është saktësuar dhe përkufizuar si indikator i përbërë, i cili përfshin komponente fizike, teknike, taktike dhe psikologjike dhe nuk trajtohet më si tregues i vetëm apo i thjeshtë. Ky variabël operacionalizohet përmes kombinimit të treguesve objektivë dhe subjektivë të performancës, me qëllim të sigurimit të një vlerësimi sa më gjithëpërfshirës dhe valid.

Treguesit objektivë përfshijnë të dhënat statistikore të ndeshjeve, si numri i golave të shënuar, asistet dhe veprimet mbrojtëse të realizuara. Ndërkaq, treguesit subjektivë përfshijnë vlerësimet profesionale të trajnerëve mbi performancën individuale dhe ekipore të sportisteve, të bazuara në kriteret teknike, taktike dhe angazhimin gjatë lojës.

Raporti ndërmjet variablave

Fokusi kryesor i këtij studimi është analiza e marrëdhënies ndërmjet vetëbesimit sportiv dhe performancës sportive. Nëpërmjet analizave statistikore përkatëse, synohet të vlerësohet nëse nivelet më të larta të vetëbesimit sportiv janë të lidhura në mënyrë domethënëse me performancë më të lartë sportive tek hendbollistet e reja.

5.3. Instrumentet matëse

Për matjen e vetëbesimit sportiv në këtë hulumtim është përdorur instrumenti i standardizuar Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI), i zhvilluar nga Vealey, i cili konsiderohet një nga instrumentet më të përdorura dhe më të besueshme në psikologjinë e sportit për vlerësimin e vetëbesimit si tipar relativisht i qëndrueshëm psikologjik.

TSCI është validuar ndërkombëtarisht dhe është përdorur gjerësisht në studime që përfshijnë sportistë të rinj dhe profesionistë nga disiplina të ndryshme sportive, duke treguar nivele të larta të besueshmërisë dhe validitetit konstruktiv. Ky instrument është veçanërisht i përshatshëm për kontekstin e këtij studimi, pasi fokusohet në vetëbesimin sportiv në situata konkurruese, që përbën një aspekt kyç të performancës në hendboll.

Instrumenti përbëhet nga 13 artikuj, të cilët vlerësojnë perceptimin e sportistës mbi aftësitë e saj në dimensione të ndryshme të performancës sportive, përfshirë:

- aftësitë teknike,
- aftësitë taktike,
- aspektet psikologjike të performancës gjatë konkurrencës.

Përdorimi i kësaj shkalle mundëson ndjeshmëri më të madhe në matjen e ndryshimeve individuale në vetëbesimin sportiv.

Rezultatet e përftuara nga TSCI përpunohen duke u mbledhur në një pikë totale, e cila pasqyron nivelin e përgjithshëm të vetëbesimit sportiv të secilës sportiste. Vlerat më të larta të pikëzimit tregojnë vetëbesim më të lartë sportiv, ndërsa vlerat më të ulëta tregojnë mungesë relative të vetëbesimit në kontekstin e performancës konkurruese.

Për vlerësimin e performancës sportive, të dhënat u mblodhën përmes një qasjeje të kombinuar, duke përfshirë tregues objektivë dhe subjektivë të performancës, me qëllim të sigurimit të një vlerësimi sa më gjithëpërfshirës dhe të besueshëm. Treguesit objektivë përfshijnë të dhëna statistikore të ndeshjeve, si numri i golave të shënuar, asistet dhe veprimet mbrojtëse të realizuara gjatë lojës. Këta tregues reflektojnë drejtpërdrejt kontributin individual të sportistes në performancën ekipore.

Ndërkaq, treguesit subjektivë do të përfshijnë vlerësimet profesionale të trajnerëve, të cilat bazohen në vëzhgimin sistematik të performancës individuale dhe ekipore të sportisteve, duke marrë parasysh aspektet teknike, taktike, angazhimin dhe disiplinën gjatë lojës. Kombinimi i këtyre burimeve të të dhënave kontribuon në rritjen e validitetit të matjes së performancës sportive dhe zvogëlon rrezikun e paragjyqimeve që mund të lindin nga përdorimi i vetëm një metode matëse.

5.3.1. Përshkrimi i pyetësorit Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI)

Instrumenti i matjes (Testi)

Për matjen e vetëbesimit sportiv është përdor Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI) i Vealey, i cili është:

- Standardizuar dhe i testuar ndërkombëtarisht në sportistë të rinj dhe profesionistë.

Më poshtë është paraqitur pyetësori TSCI- Vealey

Pyetësor: Vlerësimi i Vetëbesimit në Sport (TSCI – Vealey)								
Udhëzime: Mendo për nivelin tënd të vetëbesimit kur garon në sportin tënd. Përgjigju pyetjeve të mëposhtme bazuar në mënyrën se si në të vërtetë ndihesh zakonisht kur garon në sportin tënd, jo se si do të doje të ndiheshe. Përgjigjet janë konfidenciale.								
Shkalla e vlerësimit: 1 = më e ulëta 5 = mesatare 9 = më e larta (Rretho një numër nga 1 deri në 9 për secilën pyetje.)								
1. Vetëbesim im për të kryer me sukses teknikat e nevojshme në sport është:								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
2. Vetëbesim im për të marrë vendime të rëndësishme gjatë garës është:								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
3. Vetëbesim im për të performuar nën presion është:								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
4. Vetëbesim im për të zbatuar strategji të suksesshme është:								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
5. Vetëbesim im për t'u përqendruar mjaftueshëm për të pasur sukses është:								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
6. Vetëbesim im për t'u përshtatur me situata të ndryshme të lojës dhe për të qenë i/e suksesshëm/me.								
I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

7. Vetëbesim im për të arritur objektivat konkurrues është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

8. Vetëbesim im për të qenë i/e suksesshëm/me në sport është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

9. Vetëbesim im për të pasur sukses në mënyrë të vazhdueshme është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

10. Vetëbesim im për të menduar dhe reaguar me sukses gjatë konkurrencës është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

11. Vetëbesim im për të përballuar sfidat e konkurrencës është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

12. Vetëbesim për të qenë i/e suksesshëm/me edhe kur gjasat janë kundër teje është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

13. Vetëbesim im për të rimarrë veten pas një performace të dobët dhe për të pasur sukses është:

I ulët			Mesatar			I lartë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9

- Rezultatet e pyetësorit japin një pikë totale që reflekton nivelin e përgjithshëm të vetëbesimit të sportistes.

Për performancën sportive, të dhënat janë mbledhur duke përdorur:

- Rezultatet reale të lojës (golat, asistet, mbrojtjet).
- Vlerësimet e trajnerëve mbi performancën individuale dhe ekipore.

5.4. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Procedura e mbledhjes së të dhënave është realizuar në mënyrë të planifikuar dhe të strukturuar, duke respektuar parimet etike të hulumtimit shkencor në sport. Në studim janë përfshirë hendbolliste të reja aktive nga dy klube sportive: Klubi i Hendbollit për Femra (KHF) “Tereza” dhe Klubi i Hendbollit për Femra (KHF) “Prishtina”, përkatësisht nga gjeneratat e reja konkurruese.

Fillimisht, pjesëmarrëset janë informuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar lidhur me qëllimin e studimit, rëndësinë e tij shkencore, procedurat e realizimit, si dhe mbi vullnetarizmin e pjesëmarrjes. Ato janë njoftuar se të dhënat e mbledhura do të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime shkencore. Për sportistet që janë nën moshën 18 vjeç, përveç miratimit të tyre, është siguruar edhe pëlqimi me shkrim i prindërve, në përputhje me standardet etike ndërkombëtare të hulumtimit shkencor. Pas këtij informimi, është siguruar miratimi i pjesëmarrëseve për pjesëmarrje në studim.

Plotësimi i pyetësorit *Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI)* është realizuar gjatë seancave të rregullta stërvitore, në ambiente të kontrolluara dhe të qeta, për të siguruar kushte optimale për përgjigje të sinqerta dhe të fokusuara. Pyetësori është administruar nën mbikëqyrjen e studiuesit dhe/ose trajnerëve të autorizuar të klubeve përkatëse, duke u siguruar që secila sportiste t’i kuptojë qartë udhëzimet dhe shkallën e vlerësimit. Sportistet kanë qenë aktive në procesin stërvitor në momentin e mbledhjes së të dhënave, çka rrit vlefshmërinë ekologjike të matjes së vetëbesimit sportiv.

Të dhënat mbi performancën sportive janë mbledhur nga arkivat zyrtare të klubeve, duke përfshirë statistikat e ndeshjeve, pjesëmarrjen në gara, si dhe vlerësimet profesionale të trajnerëve përkatës. Këto vlerësime janë përdorur për të krijuar një pasqyrë objektive të nivelit të performancës sportive të hendbollisteve dhe për të analizuar lidhjen e saj me nivelin e vetëbesimit sportiv.

5.5. Metodatat e përpunimit të rezultateve

Në përpunimin e rezultateve të këtij studimi janë përdorur këto metoda:

Metodat statistikore

<ul style="list-style-type: none">• Korelacioni sipas Spearman-it
<ul style="list-style-type: none">• Crosstabulimet (Tabelat e kryqëzuara)
<ul style="list-style-type: none">• T-testi

Në përpunimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura në këtë studim janë përdorur metoda statistikore përshkruese dhe inferenciale, me qëllim të interpretimit të rezultateve dhe verifikimit të hipotezave të parashtruara.

Korelacioni sipas Spearman-it është një metodë statistikore jo-parametrike që përdoret për të vlerësuar forcën dhe drejtimin e lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve, veçanërisht kur të dhënat janë të renditura (ordinal) ose nuk plotësojnë supozimet e shpërndarjes normale. Koeficienti i Spearman-it (ρ) merr vlera nga -1 deri në $+1$; vlerat pozitive tregojnë një lidhje pozitive (rritja e një ndryshoreje shoqërohet me rritjen e tjetrës), ndërsa vlerat negative tregojnë një lidhje të kundërt. Sa më afër ± 1 të jetë vlera e koeficientit, aq më e fortë është lidhja ndërmjet ndryshoreve.

Në këtë studim, korelacioni sipas Spearman-it është përdorur për të analizuar lidhjen ndërmjet vetëbesimit sportiv, të matur me pyetësin *Trait Sport-Confidence Inventory (TSCI)*, dhe treguesve të performancës sportive të hendbollisteve të reja. Ky test u zgjodh për shkak se disa nga të dhënat nuk ishin të shpërndara normalisht dhe disa matje ishin ordinal (si përgjigjet në pyetësor), gjë që e bën Spearman-in më të përshtatshëm se korelacioni Pearson, i cili supozon shpërndarje normale dhe intervale të barabarta midis të dhënave.

Crosstabulimet, ose tabelat e kryqëzuara, janë një metodë statistikore përshkruese që përdoret për të paraqitur shpërndarjen e të dhënave sipas dy ose më shumë ndryshoreve kategorike. Kjo metodë mundëson analizimin e frekuencave, përqindjeve dhe krahasimeve ndërmjet grupeve të ndryshme të të testuarave.

Në kuadër të këtij hulumtimi, tabelat e kryqëzuara janë përdorur për të analizuar shpërndarjen e niveleve të vetëbesimit sportiv sipas klubeve (KHF “Tereza” dhe KHF “Prishtina”), si dhe sipas kategorive të ndryshme të performancës sportive. Kjo metodë ndihmon në identifikimin

e dallimeve të mundshme strukturore ndërmjet grupeve të hulumtuara.

Para aplikimit të t-testit për të krahasuar nivelin e vetëbesimit midis hendbollistëve të dy klubeve, u verifikuan supozimet statistikore përkatëse. Normaliteti i të dhënave për secilin grup u kontrollua me testin Shapiro–Wilk, ndërsa homogjeniteti i variancave midis grupeve u vlerësua me testin e Levene. Vëzhgimet u konsideruan të pavarura, duke qenë se secila sportiste u mat vetëm një herë.

T-testi është një metodë statistikore parametrike, e cila përdoret për të testuar nëse ekziston një dallim statistikisht i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të dy grupeve të pavarura.

Në këtë studim, t-testi është përdorur për të krahasuar nivelin mesatar të vetëbesimit sportiv dhe/ose performancës sportive ndërmjet hendbollistëve të dy klubeve: KHF “Tereza” dhe KHF “Prishtina”. Përmes kësaj metode është vlerësuar nëse dallimet e vërejtura ndërmjet grupeve janë rezultat i rastësisë apo paraqesin një ndryshim real dhe domethënës nga aspekti statistik.

6. Interpretimi i tabelave dhe diskutimi

Tabela 1- Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të kryer me sukses teknikat e nevojshme në sport:

Klubet		N 2	N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF	Frek.	0	0	2	4	9	11	6	4	36
Tereza	%	0.0%	0.0%	5.6%	11.1%	25.0%	30.6%	16.7%	11.1%	100.0%
KHF	Frek.	1	2	8	4	10	4	5	0	34
Prishtina	%	2.9%	5.9%	23.5%	11.8%	29.4%	11.8%	14.7%	0.0%	100.0%
Total	Frek.	1	2	10	8	19	15	11	4	70
	%	1.4%	2.9%	14.3%	11.4%	27.1%	21.4%	15.7%	5.7%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	13.964	0.052
N of Valid Cases	70	

Tabela 1 paraqet vlerësimin e qëndrimit lidhur me vetëbesimin për të kryer me sukses teknikat e nevojshme në sport tregon dallime të qarta ndërmjet KHF Tereza dhe KHF Prishtina. Analiza e shpërndarjes së notave N2–N9 sugjeron se dy ekipet kanë profile të ndryshme të vetëbesimit teknik, si në nivelin e përgjithshëm ashtu edhe në strukturën e brendshme të vlerësimeve.

KHF Tereza paraqet një model të konsoliduar dhe të orientuar qartë drejt niveleve të larta të vetëbesimit. Notat N6 (25.0%), N7 (30.6%), N8 (16.7%) dhe N9 (11.1%) dominojnë profilin e këtij ekipi, duke bërë që mbi 72% e lojtareve të jenë të pozicionuara në zona të vetëbesimit të lartë. Mungesa e plotë e vlerësimeve të ulëta (N2 dhe N3 = 0%) tregon se ekipi ka një bazë të qëndrueshme dhe homogjene të vetëefikasitetit teknik. Lojtaret e Terezës e perceptojnë veten si të afta dhe të sigurta për ta përballuar me sukses komponentën teknike të sportit.

Prania e vlerave të ulëta tek KHF Prishtina në N2 (2.9%) dhe N3 (5.9%) tregon një grup lojtaresh me vetëbesim të reduktuar. Edhe pse një pjesë e ekipit arrin nivele më të mira, veçanërisht në N6 (29.4%) dhe N8 (14.7%), përqendrimi më i lartë shfaqet në notën N4 (23.5%), duke reflektuar një vetëbesim të mesëm. Mungesa totale e vlerësimeve në nivelin më të lartë N9 (0%) tregon se ekipi nuk arrin kulmin e vetëbesimit teknik që vërehet te KHF Tereza.

Krahasimi i strukturave tregon qartë se KHF Tereza dominon me nivele të larta të vetëbesimit

(N6–N9), ndërsa KHF Prishtina pozicionohet kryesisht në nivelet mesatare (N4–N6), me prani të konsiderueshme në nivelet e ulëta. Kjo e vendos KHF Terezën në një avantazh të dukshëm psikologjik teknik.

Testi Pearson Chi-Square ($X^2 = 13.964$, $p = 0.052$) tregon se dallimet midis ekipeve nuk janë statistikorisht të rëndësishme, megjithëse vlera p është shumë pranë kufirit të rëndësisë. Kjo sugjeron një tendencë të fortë drejt diferencimit praktik, duke mbështetur interpretimin se KHF Tereza paraqet vetëbesim teknik dukshëm më të lartë se KHF Prishtina.

Tabela 2- Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të marrë vendime të rëndësishme gjatë garës:

Klubet		N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF	Frek.	1	5	8	7	2	8	5	36
Tereza	%	2.8%	13.9%	22.2%	19.4%	5.6%	22.2%	13.9%	100.0%
KHF	Frek.	3	11	4	4	7	4	1	34
Prishtina	%	8.8%	32.4%	11.8%	11.8%	20.6%	11.8%	2.9%	100.0%
Total	Frek.	4	16	12	11	9	12	6	70
	%	5.7%	22.9%	17.1%	15.7%	12.9%	17.1%	8.6%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.132 ^a	0.059
N of Valid Cases	70	

Rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për marrjen e vendimeve të rëndësishme gjatë garës (tabela 2) tregojnë dallime të dukshme midis dy klubeve të hendbollit të femrave. Ky dimension reflekton aftësinë e lojtareve për të reaguar në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe të sigurt në situata që ndikojnë drejtpërdrejt në rrjedhën e lojës.

Te KHF Tereza, vërehet një shpërndarje më e balancuar dhe e orientuar drejt niveleve të mesme dhe të larta të vetëbesimit. Notat N5 (22.2%), N6 (19.4%) dhe N8 (22.2%) janë më të pranishmet, duke treguar se një përqindje e konsiderueshme e lojtareve e perceptojnë veten si të afta të marrin vendime cilësore në situata me rëndësi të madhe. Prania e moderuar e vlerësimeve N4 (13.9%) dhe N9 (13.9%) e pasuron këtë profil, ndërsa N3 paraqet vetëm 2.8%, çka sugjeron se niveli i ulët i vetëbesimit është shumë i rrallë në këtë ekip. Klubi Tereza prezanton një strukturë të qëndrueshme psikologjike, ku shumica e lojtareve ndihen të sigurt

në vendimmarrjen garuese.

Në krahasim, KHF Prishtina shfaq një shpërndarje më të përqendruar në nivelet e ulëta dhe të mesme. Nota N4 është dominuese (32.4%), duke reflektuar një vetëbesim të moderuar dhe jo plotësisht të konsoliduar në situata vendimtare. Ndërsa N7 (20.6%) sugjeron prani të vetëbesimit më të lartë, frekuencat e ulëta në N8 (11.8%) dhe N9 (2.9%) tregojnë se vetëm një pjesë shumë e vogël e lojtareve arrin nivele më të avancuara të sigurisë psikologjike. Prania e vlerësimeve të ulëta si N3 (8.8%) nënvizon variabilitetin e ndjeshëm brenda ekipit të Prishtinës, duke treguar një profil më të paqëndrueshëm krahasuar me Terezën.

Rezultati i testit Pearson Chi-Square ($p = 0.059$) tregon se dallimet midis dy ekipeve nuk janë statistikorisht të rëndësishme, por vlera p është shumë pranë kufirit tradicional të domethënies, duke sugjeruar një tendencë të qartë të diferencimit. Në terma praktikë, të dhënat sugjerojnë se lojtaret e KHF Tereza kanë vetëbesim më të lartë dhe më të strukturuar në marrjen e vendimeve të rëndësishme gjatë garës, ndërsa KHF Prishtina paraqet nivele më të moderuara dhe më pak të konsoliduara të këtij aspekti të performancës psikologjike.

Tabela 3- - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të performuar nën presion:

Klubet		N 1	N 2	N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF	Frek.	0	2	5	9	7	8	1	3	1	36
Tereza	%	0.0%	5.6%	13.9%	25.0%	19.4%	22.2%	2.8%	8.3%	2.8%	100.0%
KHF	Frek.	3	3	2	4	11	9	1	0	1	34
Prishtina	%	8.8%	8.8%	5.9%	11.8%	32.4%	26.5%	2.9%	0.0%	2.9%	100.0%
Total	Frek.	3	5	7	13	18	17	2	3	2	70
	%	4.3%	7.1%	10.0%	18.6%	25.7%	24.3%	2.9%	4.3%	2.9%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	10.308	0.244
N of Valid Cases	70	

Tabela 3 paraqet vlerësimin e vetëbesimit të lojtareve për të performuar nën presion, krahasuar midis dy klubeve të hendbollit të femrave, KHF Tereza dhe KHF Prishtina. Ky dimension përfaqëson një komponent të rëndësishëm të kompetencave psikologjike, pasi aftësia për të ruajtur efikasitetin teknik dhe emocional në situata presioni është thelbësore për sportet ekipore me ritëm të lartë si hendbolli.

Shpërndarja e përgjithshme tregon se të dy klubet kanë një prirje relativisht të ngjashme drejt niveleve mesatare dhe të larta të vetëbesimit. KHF Tereza ka përqendrim më të lartë në nivelet N4 (25.0%) dhe N6 (22.2%), ndërsa KHF Prishtina përqendrohet më shumë në N5 (32.4%) dhe N6 (26.5%). Kjo tregon se të dy ekipet perceptojnë një nivel të caktuar sigurie për përballimin e situatave të presionit, megjithëse struktura e shpërndarjes ndryshon pak.

Diferencat më të dukshme shfaqen në nivelet më të ulëta të vetëbesimit. KHF Prishtina ka përqindje më të lartë në N1 dhe N2 (gjithsej 17.6%), ndërsa KHF Tereza vetëm 5.6% në këto dy nivele. Kjo sugjeron se ekipi i Prishtinës ka një grup më të madh lojtare që ndihen të pasigurta kur vendosen nën presion, çka mund të ndikojë në stabilitetin emocional gjatë lojës. Nga ana tjetër, KHF Tereza paraqet një shpërndarje më të balancuar dhe ka më pak prani në nivelet shumë të ulëta.

Sa u përket vlerave të larta, të dy ekipet kanë përqindje të ulët në N7–N9, megjithëse KHF Tereza paraqet pak më shumë vlerësime në grupin e lartë (13.9% së bashku) krahasuar me Prishtinën (5.8%). Kjo sugjeron se numri i lojtareve me vetëbesim shumë të lartë nën presion është përgjithësisht i vogël në të dy klubet.

Rezultati i testit statistik Pearson Chi-Square ($p = 0.244$) tregon se nuk ekzistojnë dallime statistikisht të domethëna midis klubeve në këtë dimension. Kjo nënkupton se, megjithëse ka ndryshime të lehta në shpërndarje, këto nuk janë mjaftueshëm të mëdha për të justifikuar një përfundim të bazuar në diferenca të rëndësishme statistikore.

Tabela 4 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të zbatuar strategji të suksesshme:

Klubet		N 2	N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	1	2	0	4	11	9	4	5	36
	%	2.8%	5.6%	0.0%	11.1%	30.6%	25.0%	11.1%	13.9%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	2	1	6	7	7	8	3	0	34
	%	5.9%	2.9%	17.6%	20.6%	20.6%	23.5%	8.8%	0.0%	100.0%
Total	Frek.	3	3	6	11	18	17	7	5	70
	%	4.3%	4.3%	8.6%	15.7%	25.7%	24.3%	10.0%	7.1%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	13.529	0.060
N of Valid Cases	70	

Vlerësimin e vetëbesimit të lojtareve për të zbatuar strategji të suksesshme gjatë lojës, një komponent i rëndësishëm i performancës taktike në sportin e hendbollit. Shpërndarja e përgjithshme e vlerësimeve tregon se të dy klubet, KHF Tereza dhe KHF Prishtina, paraqesin profile të ndryshme të vetëbesimit në këtë dimension, me tendenca të qarta drejt niveleve të mesme dhe të larta.

Në ekipin e KHF Tereza, shpërndarja është më e konsoliduar dhe priret fort drejt niveleve të larta të vetëbesimit. Përqendrimi më i madh gjendet në vlerat N6 (30.6%) dhe N7 (25.0%), të cilat së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e ekipit. Përveç kësaj, nivelet e larta N8 (11.1%) dhe N9 (13.9%) tregojnë se një pjesë e lojtareve kanë vetëbesim të avancuar në zbatimin e strategjive të suksesshme. Mungesa totale e vlerësimeve në kategorinë N4 dhe niveli shumë i ulët në N2–N3 sugjerojnë një stabilitet të lartë në këtë aspekt.

Në krahasim, KHF Prishtina paraqet një shpërndarje më të përhapur dhe më pak të qëndrueshme të vlerësimeve. Ndër nivelet më të ulëta, ekipi paraqet 5.9% në N2 dhe 2.9% në N3, por diferencimi më i madh shihet në kategorinë N4 (17.6%), ku përqendrimi është dukshëm më i lartë se te KHF Tereza. Në nivelet mesatare dhe të larta, Prishtina paraqet vlera të krahasueshme në N5 (20.6%), N6 (20.6%) dhe N7 (23.5%), por ka një mungesë të plotë të vlerësimeve në nivelin N9, çka sugjeron se prania e vetëbesimit shumë të lartë është më e kufizuar në këtë ekip.

Krahasimi midis dy klubeve tregon se KHF Tereza ka një shpërndarje më të fortë në nivelet e larta të vetëbesimit (N6–N9), ndërsa KHF Prishtina ka përqendrim më të lartë në nivelet e ulëta dhe mesatare (N2–N5). Ky kontrast nënkupton se lojtarët e KHF Tereza kanë një aftësi më të mirë të perceptuar për të zbatuar strategji komplekse dhe për të marrë vendime taktike të suksesshme gjatë garës.

Rezultati i testit Pearson Chi-Square ($p = 0.060$) sugjeron se dallimet midis dy klubeve nuk janë statistikisht të domethënës sipas pragut standard të rëndësisë ($p < 0.05$). Megjithatë, vlera p është shumë pranë kufirit të rëndësisë, duke treguar një tendencë të qartë drejt një dallimi të vërtetë në shpërndarjen e vetëbesimit.

Tabela 5 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për t'u përqendruar mjaftueshëm për të pasur sukses:

Klubet		N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	2	0	3	15	4	12	36
	%	5.6%	0.0%	8.3%	41.7%	11.1%	33.3%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	0	4	8	8	4	10	34
	%	0.0%	11.8%	23.5%	23.5%	11.8%	29.4%	100.0%
Total	Frek.	2	4	11	23	8	22	70
	%	2.9%	5.7%	15.7%	32.9%	11.4%	31.4%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	10.536	0.061
N of Valid Cases	70	

Rezultatet e paraqitura në këtë pjesë ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi vetëbesimin e lojtareve në aftësinë për t'u përqendruar mjaftueshëm për të pasur sukses gjatë garës. Të dhënat tregojnë dallime të dukshme midis dy klubeve të hendbollit të femrave, KHF Tereza dhe KHF Prishtina, si në nivelin e shpërndarjes së vlerësimeve, ashtu edhe në tendencën e përgjithshme të vetëbesimit.

Në ekipin e KHF Tereza, shpërndarja e vlerësimeve tregon një orientim të fortë drejt niveleve të larta. Nota N7 përfaqëson vlerësimin më të shpeshtë (41.7%), e ndjekur nga N9 (33.3%). Këto dy kategori përbëjnë pothuajse tri të katërtat e grupit, duke sugjeruar se lojtaret e Terezës kanë një nivel të lartë besimi në aftësinë për të ruajtur përqendrimin gjatë situatave të rëndësishme garuese. Frekuencat më të ulëta në N4 (5.6%) dhe mungesa në N5 tregojnë një stabilitet të mirë të performancës psikologjike.

Në krahasim, KHF Prishtina paraqet një shpërndarje më të heterogjenë. Edhe pse ka prani të konsiderueshme në nivelin N9 (29.4%) dhe N7 (23.5%), një pjesë e lojtareve vlerësojnë vetëbesimin e tyre në nivele mesatare, si N5 (11.8%) dhe N6 (23.5%). Kjo tregon një nivel më të paqëndrueshëm ose të ndryshueshëm të përqendrimit të perceptuar, krahasuar me strukturën më të konsoliduar të Terezës.

Rezultati i testit Pearson Chi-Square ($p = 0.061$) sugjeron se dallimet midis dy klubeve nuk janë statistikisht të domethënës, megjithëse vlera p është shumë pranë kufirit të rëndësisë. Kjo

tregon një tendencë diferencimi, por jo një dallim të konfirmuar statistikiisht.

Në përfundim, lojtaret e KHF Tereza paraqesin një vetëbesim më të qëndrueshëm dhe më të lartë në aftësinë për të ruajtur përqendrimin, ndërsa KHF Prishtina paraqet një profil më të shpërndarë dhe me më shumë variabilitet psikologjik.

Tabela 6 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për t'u përshtatur me situata të ndryshme të lojës dhe për të qenë i/e suksesshëm/me:

Klubet		N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	0	5	6	8	6	3	8	36
KHF Prishtina	%	0.0%	13.9%	16.7%	22.2%	16.7%	8.3%	22.2%	100.0%
Total	Frek.	2	10	9	5	0	7	1	34
	%	5.9%	29.4%	26.5%	14.7%	0.0%	20.6%	2.9%	100.0%
	Frek.	2	15	15	13	6	10	9	70
	%	2.9%	21.4%	21.4%	18.6%	8.6%	14.3%	12.9%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	17.961	0.006
N of Valid Cases	70	

Tabela 6 paraqet vlerësimin e vetëbesimit të lojtareve në aftësinë e tyre për t'u përshtatur me situata të ndryshme të lojës dhe për të qenë të suksesshme, një komponent thelbësor i fleksibilitetit taktik dhe menaxhimit të ndryshimeve dinamike gjatë garës. Rezultatet ndërmjet dy klubeve, KHF Tereza dhe KHF Prishtina, tregojnë dallime të qarta dhe statistikiisht të rëndësishme në këtë dimension.

Në ekipin e KHF Tereza, shpërndarja e vlerësimeve është e balancuar dhe me orientim të fortë drejt niveleve të mesme dhe të larta. Niveli N6 (22.2%) dhe N9 (22.2%) përfaqësojnë dy kulmet e vetëbesimit në këtë klub, ndërsa N5 dhe N7 përbëjnë secili nga 16.7%. Prania e vlerave të ulëta është minimale, me vetëm 13.9% në N4 dhe mungesë totale të vlerave në N3. Kjo tregon një profil vetëbesimi të qëndrueshëm dhe një besim të madh të lojtareve të Terezës në aftësinë e tyre për të lexuar dhe menaxhuar situata të ndryshme të lojës.

KHF Prishtina paraqet një strukturë më të shpërndarë të vlerësimeve, me përqendrim të lartë në nivelet N4 (29.4%) dhe N5 (26.5%), të cilat tregojnë një vetëbesim mesatar në aftësinë për t'u përshtatur. Shumë domethënëse është mungesa totale e vlerësimeve në N7 (0.0%), një nivel

që tregon vetëbesim të lartë taktik, dhe prania shumë e vogël në N9 (2.9%). Ndërkohë, prania e vlerësimeve në N3 (5.9%) sugjeron se një pjesë e lojtareve të Prishtinës ndihen jo mjaftueshëm të sigurta në situata të reja ose komplekse të lojës. Nga ana tjetër, vlerësimet e larta në N8 (20.6%) tregojnë se një grup i vogël i lojtarëve ka vetëbesim të fortë, por jo në të njëjtën shkallë të konsolidimit si në Tereza.

Dallimet midis dy klubeve bëhen të qarta edhe nga testimi statistikor. Rezultati i testit Pearson Chi-Square ($X^2 = 17.961$, $p = 0.006$) tregon një dallim statistikorisht të domethënës midis KHF Tereza dhe KHF Prishtina në këtë dimension. Vlera $p = 0.006$ është shumë më e ulët se pragu standard $p < 0.05$, duke konfirmuar se shpërndarjet e vetëbesimit ndryshojnë në mënyrë domethënëse mes dy ekipeve.

Tabela 7 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të arritur objektivat garuese:

Klubet		N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	3	3	7	8	3	12	36
	%	8.3%	8.3%	19.4%	22.2%	8.3%	33.3%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	0	7	14	7	3	3	34
	%	0.0%	20.6%	41.2%	20.6%	8.8%	8.8%	100.0%
Total	Frek.	3	10	21	15	6	15	70
	%	4.3%	14.3%	30.0%	21.4%	8.6%	21.4%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.353	0.030
N of Valid Cases	70	

Vlerësimet e paraqitura në këtë pjesë ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si lojtaret e të dy klubeve e perceptojnë aftësinë e tyre për të arritur objektivat garuese. Ky dimension lidhet ngushtë me orientimin drejt qëllimit, vetë-motivimin dhe forcën psikologjike që e mbështet performancën sportive.

Një strukturë vetëbesimi e orientuar drejt niveleve të larta dominon në ekipin e KHF Tereza. Nota N9 (33.3%) përfaqëson kulmin e vlerësimeve, duke dëshmuar se një pjesë e konsiderueshme e lojtareve ndihen shumë të sigurta në kapacitetin e tyre për të përmbushur objektivat garuese. Edhe vlerat N7 (22.2%) dhe N6 (19.4%) forcojnë këtë model, duke e pozicionuar ekipin me një bazë të fuqishme të vetëbesimit të avancuar. Frekuencat në nivelet

e ulëta (N4 dhe N5) janë minimale dhe sugjerojnë praninë e individëve që mund të përfitojnë nga ndërhyrje motivuese shtesë, por jo një problematikë strukturore brenda ekipit.

Në krahasim, KHF Prishtina paraqet një shpërndarje të qartë drejt niveleve mesatare të vetëbesimit. Nota N6 përbën 41.2% të ekipit, duke treguar se shumica e lojtareve e perceptojnë veten si relativisht të sigurta për arritjen e objektivave, por jo në shkallën e lartë të lojtareve të Terezës. Vlerat N5 (20.6%) dhe N7 (20.6%) tregojnë një heterogjenitet më të madh brenda ekipit, ndërsa prania e ulët e vlerësimeve në N9 (8.8%) sugjeron se vetëbesimi maksimal është shumë më i kufizuar në këtë grup.

Dallimi mes dy ekipeve bëhet i dukshëm në kontrastin midis përqendrimit të Terezës në nivelet e larta (N7–N9) dhe bazës së Prishtinës në nivelet mesatare (N5–N6). Ky kontrast sugjeron se lojtaret e Terezës kanë një orientim më të fortë drejt suksesit dhe qëllimit garues, ndërsa Prishtina shfaq një profil më të moderuar dhe më pak të njëtrajtshëm në këtë aspekt psikologjik. Testi Pearson Chi-Square ($p = 0.030$) konfirmon se diferencat midis dy klubeve janë statistikisht të domethënës, duke nënvizuar faktin se shpërndarjet e vetëbesimit ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme. Kjo vlerë p nën 0.05 sugjeron se diferencat nuk janë rastësore, por pasqyrojnë realisht strukturën psikologjike të secilit ekip.

Tabela 8 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimi për të qenë i/e suksesshëm/me në sport:

Klubet		N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	4	0	6	6	20	36
	%	11.1%	0.0%	16.7%	16.7%	55.6%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	6	1	5	15	7	34
	%	17.6%	2.9%	14.7%	44.1%	20.6%	100.0%
Total	Frek.	10	1	11	21	27	70
	%	14.3%	1.4%	15.7%	30.0%	38.6%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	11.560	0.021
N of Valid Cases	70	

Vlerësimet për vetëbesimin në suksesin sportiv ofrojnë një krahasim domethënës midis dy klubeve, duke nxjerrë në pah nivelet e ndryshme të sigurisë psikologjike që lojtaret kanë për arritjen e suksesit sportiv. Ky dimension lidhet me vetëefikasitetin, motivimin afatgjatë dhe

pritshmëritë individuale për performancë.

Lojtarët e KHF Tereza shfaqin një orientim të theksuar drejt niveleve më të larta të vetëbesimit. Nota N9 është dominante (55.6%), duke përbërë mbi gjysmën e të gjitha vlerësimeve, çka tregon një bindje të fortë në aftësinë për të qenë të suksesshme në sport. Për më tepër, N7 dhe N8 (secila me 16.7%) rrisin më tej profilin pozitiv të ekipit. Vlerësimet më të ulëta janë të kufizuara (N5 = 11.1%) dhe mungesa totale e vlerësimit N6 thekson stabilitetin e lartë të vetëbesimit në këtë grup.

Në anën tjetër, KHF Prishtina paraqet një shpërndarje më të balancuar, por jo në nivele aq të larta. Nota N8 është më e përfaqësuar (44.1%), çka tregon një prani të fortë të vetëbesimit, por jo të krahasueshme me intensitetin e Terezës. N9 shfaqet në vetëm 20.6% të rasteve, ndërsa niveli N5 (17.6%) dhe prania e vlerësimit N6 (2.9%) tregojnë një variabilitet më të madh dhe një bazë më të përzier vetëbesimi.

Në përgjithësi, krahasimi midis dy ekipeve tregon se KHF Tereza ka një profil të fuqishëm psikologjik, të orientuar drejt vetëbesimit shumë të lartë, ndërsa KHF Prishtina ka një shpërndarje më të moderuar dhe më pak të përqendruar në nivelet shumë të larta të vlerësimit. Dallimet mes dy klubeve janë statistikisht të domethënës, siç tregohet nga rezultati i testit Pearson Chi-Square ($p = 0.021$), duke konfirmuar se shpërndarjet e vetëbesimit ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme. Kjo sugjeron se lojtarët e KHF Tereza kanë një avantazh të qartë psikologjik në raport me kompetitivitetin dhe suksesin sportiv.

Tabela 9 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të pasur sukses në mënyrë të vazhdueshme:

Klubet		N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	1	2	0	9	15	4	5	36
	%	2.8%	5.6%	0.0%	25.0%	41.7%	11.1%	13.9%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	0	1	4	10	6	6	7	34
	%	0.0%	2.9%	11.8%	29.4%	17.6%	17.6%	20.6%	100.0%
Total	Frek.	1	3	4	19	21	10	12	70
	%	1.4%	4.3%	5.7%	27.1%	30.0%	14.3%	17.1%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	9.927	0.128
N of Valid Cases	70	

Vlerësimet e kësaj pjese japin një panoramë të rëndësishme mbi vetëbesimin e lojtareve në ruajtjen e suksesit në mënyrë të qëndrueshme, një komponent i lidhur ngushtë me stabilitetin psikologjik dhe aftësinë për të performuar në nivel të lartë për periodha të gjata. Diferencat midis dy klubeve shfaqin modele të ndryshme të vetëvlerësimit.

Një përqendrim të theksuar në nivelet e larta të vetëbesimit është për lojtaret e KHF Tereza. Vlerësimi më i shpeshtë është Nota N7 (41.7%), duke reflektuar një siguri të fortë në qëndrueshmërinë e performancës së tyre. Një pjesë e konsiderueshme e lojtareve vlerësojnë veten në N6 (25.0%), ndërsa prania e vlerave të ulëta është minimale, me vetëm disa raste në N3 dhe N4. Mungesa totale e vlerësimit N5 sugjeron se pak lojtare e perceptojnë suksesin e tyre si të paqëndrueshëm apo të pasigurt. Në tërësi, struktura e vlerësimeve tregon një profil të lartë psikologjik dhe një besim të konsoliduar në aftësinë për të ruajtur performancën garuese. Në ekipin e KHF Prishtina, shpërndarja e vlerësimeve është më e balancuar, duke përfshirë nivele të ulëta, mesatare dhe të larta. Niveli N6 (29.4%) është më i pranishmi, çka sugjeron një vetëbesim të moderuar, ndërsa N7 (17.6%) dhe N9 (20.6%) tregojnë se një pjesë e ekipit ka besim të lartë në qëndrueshmërinë e suksesit. Nga ana tjetër, prania e vlerësimeve N5 (11.8%) dhe N4 (2.9%) tregon se disa lojtare dyshojnë në aftësinë për të mbajtur performancë të njëtrajtshme. Në përgjithësi, profili i Prishtinës është më heterogjen dhe më pak i përqendruar në nivelet shumë të larta të vetëbesimit.

Testi Pearson Chi-Square ($p = 0.128$) tregon se dallimet midis dy grupeve nuk janë statistikisht të domethënës. Megjithatë, tendenca e përgjithshme sugjeron se KHF Tereza paraqet një vetëbesim më të fortë dhe më të qëndrueshëm në raport me suksesin afatgjatë.

Tabela 10 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të menduar dhe reaguar me sukses gjatë konkurrencës:

Klubet		N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF	Frek.	1	3	8	3	8	5	8	36
Tereza	%	2.8%	8.3%	22.2%	8.3%	22.2%	13.9%	22.2%	100.0%
KHF	Frek.	0	6	7	8	3	5	5	34
Prishtina	%	0.0%	17.6%	20.6%	23.5%	8.8%	14.7%	14.7%	100.0%
Total	Frek.	1	9	15	11	11	10	13	70
	%	1.4%	12.9%	21.4%	15.7%	15.7%	14.3%	18.6%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.253	0.298
N of Valid Cases	70	

Në këtë pjesë vërehen modele të ndryshme të vetëbesimit që lidhen me aftësinë e lojtareve për të menduar dhe reaguar me efikasitet gjatë garës, një aspekt kyç i vendimmarrjes sportive dhe menaxhimit të presionit. Të dhënat tregojnë se të dy klubet shfaqin profile psikologjike të dallueshme në këtë dimension.

Te KHF Tereza, vlerësimet shpërndahen në disa nivele, por me një prirje të qartë drejt kategorive të larta. Notat N5, N7 dhe N9 janë më të përfaqësuarat (secila me 22.2%), duke krijuar një strukturë simetrike të vetëbesimit të lartë në situata që kërkojnë mendim të shpejtë dhe reagim taktik. Prania e moderuar e vlerësimeve të ulëta (N3 dhe N4) është minimale dhe nuk e prish qëndrueshmërinë e profilit të përgjithshëm.

Ndryshe nga kjo, KHF Prishtina shfaq një shpërndarje më të theksuar drejt niveleve mesatare. Kategoria N6 (23.5%) është më e frekuentuar, e cila tregon një besim të moderuar, por jo në nivelin e lartë të Terezës. Edhe pse N8 dhe N9 janë të pranishme, ato nuk arrijnë të dominojnë strukturën e ekipit. Nga ana tjetër, N4 (17.6%) paraqet një përqindje të konsiderueshme të lojtareve me vetëbesim më të ulët gjatë vendimmarrjes në garë.

Pavarësisht dallimeve të vëzhguara në shpërndarjet e vlerësimeve, testi Pearson Chi-Square ($p = 0.298$) tregon se këto ndryshime nuk janë statistikisht të domethënës. Kjo nënkupton se variacionet midis dy klubeve mund të jenë rezultat i faktorëve individualë dhe jo i diferencave të qëndrueshme strukturore.

Në mënyrë përmbledhëse, KHF Tereza paraqet një profil më të balancuar dhe më të orientuar drejt vetëbesimit të lartë, ndërsa KHF Prishtina karakterizohet nga një prirje më e fortë drejt niveleve mesatare të vetëbesimit në reagim dhe vendimmarrje gjatë konkurrencës.

Tabela 11 - Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të përballuar sfidat e garës:

Klubet		N 1	N 2	N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF	Frek.	0	1	0	1	9	2	11	6	6	36
Tereza	%	0.0%	2.8%	0.0%	2.8%	25.0%	5.6%	30.6%	16.7%	16.7%	100.0%
KHF	Frek.	1	0	2	2	4	14	6	4	1	34
Prishtina	%	2.9%	0.0%	5.9%	5.9%	11.8%	41.2%	17.6%	11.8%	2.9%	100.0%
Total	Frek.	1	1	2	3	13	16	17	10	7	70
	%	1.4%	1.4%	2.9%	4.3%	18.6%	22.9%	24.3%	14.3%	10.0%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	20.658	0.008
N of Valid Cases	70	

Aftësia për të përballuar sfidat e garës përfaqëson një aspekt kyç të qëndrueshmërisë psikologjike dhe rezistencës emocionale të lojtareve. Shpërndarja e vlerësimeve të këtij dimensionit tregon kontraste të dukshme midis KHF Tereza dhe KHF Prishtina, si në orientimin e përgjithshëm të vetëbesimit, ashtu edhe në mënyrën se si lojtaret e secilit ekip e përjetojnë presionin garues.

Te KHF Tereza, vlerësimet fokusohen kryesisht në nivelet e larta. Kategoria N7 (30.6%) përbën frekuencën më të madhe, duke sinjalizuar një vetëbesim të fortë në aftësinë për t'u përballur me sfidat e ndryshme që paraqiten gjatë garës. N5 (25.0%) dhe N8–N9 (secila me 16.7%) e përforcojnë këtë model të konsoliduar të besimit psikologjik. Prania e vlerave të ulëta është minimale, duke reflektuar një stabilitet të lartë emocional brenda ekipit.

KHF Prishtina paraqet një model të ndryshëm. Niveli N6 dominohet nga 41.2% e lojtareve, duke sugjeruar një vetëbesim të moderuar, por jo maksimal, në përballimin e sfidave. Për më tepër, vlerat në N7 (17.6%), N8 (11.8%) dhe N9 (2.9%) tregojnë prani të vetëbesimit të lartë, por në përmasa dukshëm më të ulëta se te Tereza. Prania e vlerësimeve të ulëta (N3 dhe N4) është më e dukshme në këtë ekip, duke reflektuar variabilitet më të madh emocional dhe psikologjik.

Diferencat strukturore mes dy klubeve konfirmohen nga rezultati i testit Pearson Chi-Square ($p = 0.008$), i cili tregon se dallimi është statistikisht i domethënës. Kjo sugjeron se mënyra se si lojtaret e secilit ekip përballen me sfidat e garës ndryshon realisht dhe nuk është rezultat i

rastësisë.

Si përfundim, KHF Tereza shfaq një vetëbesim dukshëm më të lartë dhe më të qëndrueshëm përballë sfidave të garës, ndërsa KHF Prishtina paraqet një profil më të shpërndarë dhe më të varur nga nivelet mesatare të qëndrueshmërisë psikologjike.

Tabela 12- Paraqet rezultatet e vlerësimit të vetëbesimit për të qenë i/e suksesshëm/me edhe kur gjasat janë kundër teje:

Klubet		N 1	N 2	N 3	N 4	N 5	N 6	N 7	N 8	N 9	Total
KHF Tereza	Frek.	0	0	2	4	5	10	7	3	5	36
	%	0.0%	0.0%	5.6%	11.1%	13.9%	27.8%	19.4%	8.3%	13.9%	100.0%
KHF Prishtina	Frek.	2	1	3	6	8	2	10	2	0	34
	%	5.9%	2.9%	8.8%	17.6%	23.5%	5.9%	29.4%	5.9%	0.0%	100.0%
Total	Frek.	2	1	5	10	13	12	17	5	5	70
	%	2.9%	1.4%	7.1%	14.3%	18.6%	17.1%	24.3%	7.1%	7.1%	100.0%

Chi-Square Tests

	Value	Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	15.310	0.053
N of Valid Cases	70	

Kur analizohen vlerësimet mbi aftësinë e lojtareve për të qenë të suksesshme edhe në rrethana të pafavorshme, vërehen dallime domethënëse në mënyrën se si secili ekip e përjeton sfidën psikologjike të “luftimit kundër gjasave”. Ky dimension lidhet drejtpërdrejt me reziliencën, vetëefikasitetin dhe kapacitetin për të ruajtur besimin edhe në situata ku parashikimet nuk janë optimiste.

Në rastin e KHF Tereza, vlerësimet shpërndahen në mënyrë të balancuar, por prirja drejt niveleve të larta të vetëbesimit është e qartë. Nota N6 është më e përfaqësuar (27.8%), e ndjekur nga N7 (19.4%) dhe N9 (13.9%). Këto vlera tregojnë se shumica e lojtareve të këtij ekipi e shohin veten si të afta për të përmbysur situata të vështira gjatë garës. Nivelet më të ulëta (N3 dhe N4) janë të pranishme, por në përqindje të kufizuara, çka sugjeron se vetëm një numër i vogël lojtare ndihen më pak të sigurta në këto situata.

Ndryshe nga kjo, KHF Prishtina paraqet një strukturë më të shpërndarë dhe më kontrastuese. Frekuencat më të larta shfaqen në N7 (29.4%) dhe N5 (23.5%), ndërsa prania e vlerësimeve të

